

## THIRRJE E KONFERENCËS

Në përfundim të punimeve të kësaj konference të suksesshme shkencore, ne pjesëmarrësit e saj nga Kosova, nga Shqipëria, nga SHBA dhe vende të ndryshme të botës, pas shqyrtimeve të shumta analitike dhe në thellësi arritëm në përfundimin e përbashkët që studimet shqiptare dhe posaçërisht albanistike në Amerikë, në mënyrë të veçantë në SHBA, me gjithë mungesën e ndonjë qendre rreth së cilës do të kishin pasur mundësi të gravitonin, paraqesin një degë të rëndësishme të studimeve shqiptare në botën e sotme. Me kënaqësi vërejmë se ato janë gjithnjë e në rritje, si falë pranisë gjithnjë e më të madhe shqiptare nga të gjitha trojet, ashtu dhe sidomos duke përfituar nga nivelet e larta të zhvillimeve në studimet filologjike, linguistike, sociale e historike në këtë kontinent. Duke pasur parasysh nevojat për adresimin e materieve që lidhen me botën shqiptare si të botës amerikane ashtu të komunitetit shqiptar që jeton atje, po edhe interesat e studimet në tërësi, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që kanë luajtur dhe vazhdojnë ta kenë ato studime në marrëdhëniet midis popujve dhe vendeve përkatëse, u bëjmë thirrje opinionit publik e shkencor, autoriteteteve universitare e shkencore të Kosovës e të Shqipërisë, autoriteteteve universitare e shkencore të SHBA-së, komunitetit shqiptar në SHBA dhe të gjithë faktorëve të rëndësishëm në relacionet midis botës shqiptare dhe botës amerikane, që me përparësi ta shtrojnë çështjen e themelimit të një qendre hulumtuese-arsimore të nivelit universitar me një prej qendrave universitare amerikane dhe me standarde e atjeshme. Ajo qendër do të merrej në mënyrë specifike me studimin e mësimdhënies, të gjuhës dhe të kulturës shqiptare dhe do të shërbente edhe përuajtjen e trashëgimisë së komunitetit shqiptar tashmë mbi njëshekullor në Amerikë. Bërrthama e tillë studimore do të ishte nxitje e rëndësishme përmbarështrimin dhe intensifikimin e këtyre studimeve, dhe përselitjen e mëtejme të raporteve të miqësisë kaq shumë të çmuar midis dy popujve

Prishtinë, 26 shtator 2015

Pjesëmarrësit e Konferencës Shkencore “Studimet albanistike në Amerikë – Albanian Studies in America”